ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KOMUNA E SHTIMES**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **617-24-2354-2-1-1**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për "**Mirëmbajtja e infrastruktures në Komunën e Shtimës (kontratë korrnizë tre vjeqare)**"

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i Operatorëve Ekonomik : ***"Agro Invest- 1" Sh.p.k & "Lord Group" sh.p.k***

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Mushtishë p.n

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

(Kodi postar)

23000

Numri Telefonit)

+383(0)49/111-625

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Antigona Jakupi

(Adresa elektronike)

Agroinvest001@gmail.com

13.06.2024

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH P K AGROINVEST 1 MUSHTISHTE-SUHAREKE

Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Bajram Sherifi
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

048/453/717
(Numri i Telefonit)

bajramsherifi@gmail.com
(Adresa elektronike)

13.06.2024
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë - **30.05.2024**

Hapja e ofertave - **29.04.2024**

Njoftimi mbi vendimin e AK-së - **30.05.2024**

Kërkesë për rishqyrtim- **03.06.2024**

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim **05.06.2024**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Hapja e ofertave - 29.04.2024

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [x] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji per Prokurim Publik i konsoliduar.
Neni 7 Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
Neni 52 Njoftimi i kritereve per dhenien e kontrates;
Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve;
Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional;
Neni 70 Standardet per Sigurimin e Cilesise
Neni 71 Grupet e Operatoreve Ekonomik dhe Operatoret e Huaj Ekonomik;
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese,

Rregullorja nr. 001/2022, per Prokurim Publik
Neni 38 Sqarimi i Tendereve;
Neni 40 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve;

Udhezuesi per Prokurim publik 001/2023.
Neni 10 - Sqarimi i tendereve gjate procesit te vleresimit te tendereve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK, Komuna e Shtimës, Komisioni i Vlerësimit na ka eleminuar nga ky aktivitet i prokurimit pa kurfarë baze ligjore, duke na diskriminuar dhe duke mos e vlerësuar ofertën tonë edhe përkundër se ishim me dokumentacion të plotë. Arsyjet të cilat i keni dhënë në letrën standarde për OE të eleminuar nuk qëndrojnë, sepse ne si OE i kemi të ngarkuar të gjitha dokumentat e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Ju si AK keni shkelur nenin 72 të LPP-së, duke mos kërkuar asnjë informacion lidhur me dokumentacionin që ju pretendoni se nuk ekziston në ofertën e ngarkuar nga ana e jonë.

Me këtë rast ju sqarojmë se AK, Komuna e Shtimës ka bërë shkeljen e dispozitave të LPP-së..

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Neni 59 par 4. *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e*

tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Me datë 03/05/2024, pranë Komunës së Shtimës kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim e cila është refuzuar me vendim nga Drejtoria për Prokurim Publik në kuadër të Komunës së Shtimës me arsyetimin se e kanë analizuar kërkesën për rishqyrtim dhe kanë konsideruar se oferta jonë që kemi aplikuar në tenderin **"Mirëmbajtja e infrastruktures në Komunën e Shtimës (kontratë korrnizë tre vjeqare)"** nuk i plotësojmë kriteret e përcaktuara në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit.

III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 4.

Projekte të natyrës së ngjashme, të realizuara në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titulli i projekteve, numri, data e kontraktimit data e përfundimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e të gjitha projekteve duhet të jetë, jo më e vogël se 525,000.00€. Në rast konsorcimi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

Pergjigjja e AK- se.

Ju në listën e projekteve që keni prezentuar nuk e arrini vlerën e përcaktuar nga AK për projekte të ngjashme ashtu siq është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Kërkesa 7.

Raporti për mjetet,stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit.

Pergjigjja e AK- se.

Mjetet të cilat i keni specifikuar në listë ju mungon libreza valide për automikser vetëngarkues për prodhimin e betonit 1 copë si dhe makinerinë speciale që montohet në ngarkues për prerjen e pusetave 360 shkallë 1 copë që e keni dëshmuar me një faturë ajo nuk është e vulosur e as e nënshkruar nga pranuesi i kësaj paisje.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale janë të mëdha, dhe ne do të angazhojmë një ekspert për llogaritjen e demit.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

"Agro Invest 1" Sh.p.k Suhareke konsideron se eleminimi jone me arsyetim te tille, paraqet shkelje esenciale te dispozitave ligjore, gjegjësisht është rekomanduar per dhenie te kontrates Operatori Ekonomik i cili ka ofertuar me oferte me te larte e qe eshte ne kundershtim me LPP-ne prandaj ne afatin e parapare me nenin I 08/A te LPP-se, paraqesim kete:

Ankese ndaj AK- Komuna Shtime

Pretendimi ankimor 1:

Sa i perket arysetimit te pare te eleminimit, lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional

1.Listën e kontratave të realizuara për tri vitet e kaluara financiare së bashku me referenca e kemi të kompletuar ashtu siq është kërkuar në dosje të tenderit- Vlera minimale e të gjitha projekteve duhet të jetë, jo më e vogël se **525,000.00 €.** Ne kemi paraqitur kontrata dhe referenca të natyrës së njejtë në vlerë **531. 000.00 €** te listuara si me poshtë:

- **"Intervenimi dhe mirëmbajtja ne pompa, kanalizimi atmosferik, fontana, kroje publike monumente dhe mure rezistuese- Loto-1-re", ne vlere: 103'987.40 €** e perfunduar me date **08/10/2021.**
- **"Grumbullimi, Transporti dhe Trajtimi I Mbeturinave Inerte dhe të vëllimshme" ne vlere: 254'000.00 €,** e perfunduar me date **04/10/2022.**
- **"Grumbullimi, Transporti dhe Trajtimi i Mbeturinave Inerte " ne vlere: 174'000.00 €**
- e perfunduar me date **20/05/2021.**

Keto projekte i shkojne plotesisht natyres se puneve qe do te kryhen ne projektin ne fjale.

Perveq tyre ne kemi paraqitur edhe kontrata tjera, ne paramasat e te cilave kemi perfunduar pune te ngjashme me paramasen e ketij projekti (te nenvizuara ne faktet e bashkangjitura) andaj prentendimi i AK- se nuk qëndron.

Vlera totale e referencave qe ne kemi paraqitur eshte: **1'333'348.46 €.**

Pretendimi ankimor 2:

2. Automikser për prodhim të betonit e kemi tek lista e paisjeve me nr. rendor 9. si dhe dëshminë Dud doganor ku specifikohet qartë Autobetonierke- Mikser vetëngarkues i cili është në pronësi të "AGRO INVEST 1" SH.P.K.;. Ju njoftojmë se kjo paisje është adekuate për punët të cilat parashkikohen të kryhen për mirëmbajtje të infrastukturës. Ju në njoftimin për kontratë keni kërkuar per automjetet që nuk regjistrohen të paraqiten me Dud doganor, kontrata të shitëblerjes, fatura, apo kontrata te marrura me qira të paisjeve. Kjo paisje i plotëson kriteret 100%.(provat e bashkangjitura) pasi qe posedon dud doganor fature te blerjes, dëshminë e pagesës bankare dhe dokumentin prej qendrës se regjistrimit qe nuk regjistrohet si automjet.

Pretendimi ankimor 3:

3. Makineri speciale që montohet në ngarkues për prerjen e pusetave 360 shkallë.

Për këtë paisje ju kemi ngarkuar faturen e shitëblerjes në mes te "AGRO INVEST 1" SH.P.K. dhe Kosova Europtiv SH.P.K me të gjitha të dhënat e shënuara. Ne posedojme edhe transaksionet bankare ku kemi bërë pagesen përmes bankës.(provat e bashkangjitura).

Ju si AK, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk keni respektuar dispozitat e nenit 59 dhe 72 te LPP-së, lidhur me nenin 38 të Rregullores nr. 001/2022, si dhe nenin 10 te Udhezuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik ku nuk keni kërkuar kurëfar sqarimi edhe pse ligjërisht keni pasur këtë mundësi.

Pas vendimit tuaj, na aludojme që ju si AK, keni tendenca që me veprimet e juaja të dëmtoni buxhetin e shtetit dhe të na dëmtoni edhe neve si operator ekonomik i përgjegjshem, e ku me këtë rast nuk na mbetet tjetër përveq që në rast të dëmtimit tonë t'i drejtohemi Prokurorisë së shtetit me kallëzim penal.

Përfundimisht, grupi i OE ankues bazuar në faktet, provat dhe dëshmitë e prezantuara më lartë dhe atyre të bashkangjitura në ofertë, kërkojmë që AK- Komuna e Shtimës, zyra e Prokurimit të nxjerr këtë:

VENDIM

TË APROVOHET si e bazuar në tërësi Ankesa e Grupit i Operatorëve Ekonomik ***Agro Invest Sh.p.k & Lord Group sh.p.k***

TË ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së si i kundërligjeshëm,

TË KTHEHET Lënda në Rivleresim, përkatësisht të formohet komision rivleresues profesional dhe i paanshëm ndaj ofertuesve dhe të rekomandohet grupi i OE

"AGRO INVEST 1" Sh.p.k & "LORD GROUP" Sh.p.k për dhënie të kontratës si operator i përgjegjshëm.